



MARRËVESHJE MIRËKUPTIM

E lidhur më datë 15.05.2023, në mes të:

“Sindikata e Policisë së Kosovës”, të cilën e përfaqëson kryetari z. Imer Zeqiri dhe
“Spitali Special për Terapi Fizikale me Rehabilitim Onix SPA LLC”, rr. Onix, nr. 66, 31010 Banjë, Istog, Republika e Kosovës, me NUI: 810801820, me nr. Spitalit LS-07/2018, të cilën e përfaqëson drejtori z. Xhevdet Shoshi.

Qëllimi: Shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore dhe të fizioterapisë.

Neni 1.

“SSTFR ONIX SPA LLC” merr për obligim trajtimin e pacientëve me terapi adekuate fizikale për pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të cilët vijnë me vërtetim-vendim nga Sindikata e Policisë së Kosovës.

Neni 2.

Palët u morën vesh që nga shuma njëqind e tetëdhjetë e nëntë (189) euro, një person-pacient nga Sindikata e Policisë mund të shfrytëzoj:

- Pansion rehabilitues në Objektiv Termal në dhomë dyshe – tetë(8) ditë qëndrimi ndërsa në dhomë njëshe – gjashtë(6) ditë qëndrimi.
- Pansion rehabilitues në Objektiv Onix në dhomë dyshe – shtatë(7) ditë qëndrimi ndërsa në dhomë njëshe – pesë(5) ditë qëndrimi.

Në këtë çmim janë të përfshira të gjitha shërbimet standarde të Banjës duke filluar nga: kontrollimi mjekësor, fjetja, ushqimi dhe terapitë. Me këtë çmim mund të vendoset edhe bashkëshorti-ja e policit nga Sindikata e Policisë, por që pagesa për bashkëshortin-en bëhet në momentin e vendosjes. Pagesa e shërbimeve sipas çmimit të kontraktuar për pjesëtarët e policisë do të bëhet tek përfituesi: SSTFR ONIX SPA LLC, në NLB Prishtina sh.a, me xhifrologari: 1706 0010 1233 3286, ku faturimi bëhet në momentin e vendosjes së pacientit, gjegjësisht pjesëtarit të policisë së Kosovës dhe përcjelllet tek personat gjegjës për pagesë.

Neni 3.

Koha për vendosje dhe qëndrim në Banjë caktohet me marrëveshje në mes të dy subjekteve kontraktuese respektivisht udhëheqësit të recepsionit dhe shfrytëzuesit të shërbimeve, ku paraprakisht duhet të bëhet rezervimi. Pacienti me rastin e ardhjes në Banjë duhet të ketë me vete vërtetimin - vendimin e Sindikatës për dërgim në Banjë.

Neni 4.

Marrëveshja lidhet për kohë të caktuar prej datës 15.05.2023 deri më datë 14.05.2024, me mundësi vazhdimi.

Palët mund të kërkojnë shkëputjen e kontratës pasi të ketë njoftuar një muaj më parë.

Neni 5.

Marrëveshja është përpiluar në katër (2) kopje identike, ku palët do të marrin nga dy kopje.

Neni 6.

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e të dy palëve.



Sindikata e Policisë së Kosovës
z. Imer Zeqiri



ONIX SPA LLC
Z. Imer Zeqiri